

VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.09(387)

SHTATOR 2020 ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

22 VJET PAS VDEKJES



Dr. Ymer Dishnica
- “NDERI I
KOMBIT”, i
sakrifikuari i
madh

Nga Kolonel Ing.Myfit GUXHOLLI

FAQE 2

PËRKUJTIMORE


**NJË VIT PA GJENERAL
RRAHMAN PARLLAKUN**



HALIL RAMA

FAQE 4

16 SHTATORI



**Pezë për shqiptarët
do të thotë bashkim**

Konferenca e Pezës është një
ngjarje madhore që na fton të
gjithëve të bashkëpunojmë sa
më ngushtë në respekt të his-
torisë

Nga Muharrem GJOKA - Nënkretar i OBVL

FAQE 5

Presidenti Meta dekoron 38 figura të shquara patriotike për kontributin në Luftën e Vlorës të vitit 1920

Luftëtarët e Vlorës, me gërma të arta në altarin e kombit

Kriza në Mesdhe:

“këmbana lufte, apo për
paqe të qëndrueshme” ?!

Gjeneral * Piro AHMETAJ

Në cilësinë e ekspertit për çështjet e sigurisë kombëtare, si dhe funksioneve të larta që kam ushtruar në NATO, po paraqes një përmbledhje rreth krizës në Mesdheun lindor, si dhe rekomandime strategjike për finalizimin e marrëveshjes detare Shqipëri – Greqi.

I. Një lexim strategjik i peshës gjeopolitike të rajonit të detit Mesdheut:

Mesdhu përfshin 21 shtete (ilustruar në hartën bashkëlidhur), me një sipërfaqe rreth 2,5 milion km2 dhe popullsi që po afrohet 500 milionë banorë. Disa nga vendet e Mesdheut janë anëtare të NATO, të iniciativave si, Iniciativa e Stambollit (ICI), Dialogu i Mesdheut (MDI), si dhe organizata të tjera me bazë rajonale dhe globale.

Interesi i vazhdueshëm për këtë rajon e ka kthyer atë në qendër të aktiviteteve dhe me prezencë ushtarake në rritje jo vetëm të vendeve të rajonit, por dhe të NATO-s, BE, SHBA, Rusisë, Kinës. NATO prej vitit 2001, në mënyrë permanente mban prezencë detare, me operacionin “Active Endeavour”, në përgjigje për sulmet terroriste të 11 Shtatorit, sigurimin e rrugëkalimeve detare dhe parandalimin për përhapjen e armëve të dëmtimit në masë, si dhe mbas 2016 në operacionin “Sea Guardian”, në detin Egje për menaxhimin e krizës së refugjatëve në këtë rajon.


Vijon në faqen 10



• *Meta: “Në Njëqindvjetorin e kësaj epopeje të lavdishme e nisëm në Poçemin e besëlidhjes mallakastriote të komandant Halim Hamitit, për t’u ndalur në Kalanë e Tepelenës të Selam Salarisë nga u nisën luftëtarët e jugut, u bashkuam në Pilurin e Kolë Mërkurit dhe tani jemi mes jush në Drashovicën e çetave të lumit të Vlorës, për të vazhduar më tej në Tiranën e qeverisë së Sulejman Delvinës dhe për ta finalizuar në Vlorën e Flamurit tonë Kombëtar!”*

FAQE 3

100 VJETORI I LUFTËS SË VLORËS



**Epopeja
e fitimtarëve**

5 gershor 1920-3 shtator 1920

**100 VJETORI
I
LUFTËS
KOMBËTARE
TË VLORËS
1920**



**Prof.dr. Bernard
Zotaj promovon
librin
“EPOPEJA E
FITIMTARËVE”**

FAQE 12

DEKORIMI

**Vepra e frashërlinjve
na udhëheq drejt
integritetit europian**

Muharem KAMANI

FAQE 7

NDERIMI

**SHPENDI TOPOLLAJ
PERSONALITET I
SHQUAR I KULTURËS SONË
BASHKËKOHORE**

FAQE 11

DOKUMENTARI

**MIMOZA DAJÇI,
dokumentar mbi persekucionin
politik të grave**

FAQE 10

MESAZHI

**OBVL, MESAZH URIMI
PËR GJENERALMAJOR,
BAJRAM BEGAJ -
SHEF I SHTABIT TË
PËRGJITHSHËM TË FA
TË RSH**

FAQE 8

REFLEKSIONE

**MIRËNJOHJA E PIKTORIT
ALAJDIN TABAKU PËR
DR.KAPISYZIN**

FAQE 8

22 VJET PAS VDEKJES

Një nga figurat më simpatike, më të mençura, më fisnike dhe një nga udhëheqësit kryesorë të LANÇ-it

Dr. Ymer Dishnica - “NDERI I KOMBIT”, i sakrifikuari i madh



Nga Kolonel Ing. Myfit GUXHOLLI

Ndër 14 figurat e shquara të historisë sonë shqiptare që dhanë kontribut për Pavarësinë dhe çështjet kombëtare, të dekoruara nga ish- Presidenti i Republikës Bujar Nishani, më 28 Nëntor 2014, Dr. Ymer Dishnica zë vend të veçantë. Duke i dhënë Dr. Ymer Dishnicës Titullin “Nderi i Kombit”, kreu i shtetit nderoi një njeri emblematic, të edukuar, të shkollur, të përkushtuar dhe të kulturuar në shkallën mësipërore që do të kujtohet për njëkohë shumë të gjatë dhe do të zerë vendin e merituar në panteonin e nderit të kombit shqiptar

Ymer Dishnica (1912-1992), ka qenë një nga figurat më simpatike, më të mençura, më fisnike dhe një nga udhëheqësit kryesorë të LANÇ-it. Ai u lind në fshatin Dishnicë më 21.2.1912, vetëm 4 km afër qytetit të Korçës. Ymer Dishnica është moshatar me pavarësisë kombëtare dhe është bir i denjë i një familje me tradita të shquara atdhetare e cila i ka dhënë Shqipërisë pesë dëshmorë, përfshi edhe një vëlla të doktor Y. Dishnicës. Ai është një nga veprimtarët më të shquar antifashistë frankofonë të Shqipërisë.

Njerëzit si Y. Dishnica kishin cilësi të ralla kulturore, komunikative e propagandistike bindëse. Ai ishte i aftë të bisedonte bindshëm me njerëz të natyrave dhe karaktereve të ndryshme. I edukuar në një ambient fshatar por edhe qytetar si Korça apo Evropian si Parisi dhe Franca kishte aftësi bindëse të çuditëshme. Agjikator i jashtëzakonshëm i tipit të ri antifashist, Ymeri e kuptonte me lehtësi hallet e un nga fshati, qyteti apo aleatët e huaj. Ai nuk ishte njeri i nënështuar dhe nuk ndjente komplekse inferioriteti ndaj askujt, sidomos ndaj përfaqësuesve të aleatëve. Me përfaqësuesit e forcave kundërshtarë të djathta, doktor Ymeri bisedonte pa kërcënime dhe fyerje dhe ishte në gjendje të kuptonte kompromisin nga nënshtrimi.

Ministri i Shëndetësisë i qeverisë të parë demokratike shqiptare ishte gjithashtu anëtar i KQ dhe Byrosë Politike të PKSh, anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacional Çlirimtar, besnik i kauzës antifashiste dhe komuniste dhe bindjeve të tij të cilat i kishte pëqafuar që shumë kohë para formimit të PKSh kur ndodhej në Francë. Ky personalitet i shquar i kapaciteteve të mëdha, i kalonte përmasat e Shqipërisë, me integritetin e tij intelektual e moral.

Më pas, Ymer Dishnicën e përjashtuan nga KQ i PKSh dhe Byroja Politike dhe kështu filloi kalvari i tij i gjatë i të përndjekurit politik.

Kush ishte Ymet Dishnica?

Arsimin fillor e nisi në vendlindje dhe përfundoi në Korçë, ndërsa arsimin e mesëm me rezultate të shkëlqyera e përfundoi në Liceun kombëtar francez të këtij qyteti (1932). Pas kësaj Ymer Dishnica u nis për në Francë ku do të studionte për tetë vjet në Universitetin e Lionit dhe më pas atë të Parisit për mjekësi (1932-1941), duke u lauruar e specializuar për patologji.

Y. Dishnica nga natyra ishte njeri intelektual me kërkesa dhe kapacitete të larta kulturore. Ai në ato vite kurrësi nuk mund të mos vizitonte Tyleritë dhe muzeumin e famshëm të Luvrit sidhe muzetë e shumtë të Parisit dhe qyteteve të Francës, arkitekturën klasike dhe moderne të Francës. Ai vizitoi teatrot dhe galeritë e shumta të arteve të “kryeqytetit të botës”. Paralel me studimet ai nuk mund të mos vizitonte pyjet dhe parqet e rrethinave të Parisit, brigjet e plazhet e lumit Sena etj. Por ai ishte edhe një militant komunist që i përqafoi idetë e majta në Francën antifashiste e cila ishte ngritur e gjitha në këmbë për të mbrojtur lirinë dhe demokracinë e kërcënuar nga fashizmi italian, ai fankist spanjoll dhe nazizmi gjerman.

Në Evropë po frynin erërat e barutit të luftës dhe po buçisnin oshëtimat e artillerisë dhe aviacionit. Gjatë qëndrimit në Francë doktori i ri ka qenë për tetë vjet anëtar i PKF dhe drejtues i komunitetit antifashist shqiptar.

Gjatë qëndrimit në Francë, së bashku me Nako Spirun, Qamil Çelën, Sejfulla Maleshovën, Dhori Samsurin, Gogo dhe Kozma Nushin e shokë të tjerë, ka organizuar protesta të fuqishme në mbështetje të popullit spanjoll kundër rebelimit fashist të Frankos dhe mbështetjes të vullnetarëve shqiptarë që luftonin në Spanjë si: Mehmet Shehu, Skënder Luarasi, Petro Marko, Mane Nishova, Asim Vokshi, Justina Shkupi që ka punuar spitalet dhe infiermeritë me doktor Betynin e famshëm, “Mjekun e tre kontinenteve” e shumë të tjerë.

Ymeri ka pritur e përcjellë vullnetarët shqiptarë për në front. Të parin ndër ta ai ka takuar Petro Markon e më pas edhe të tjerët.

Një nga aktivistët veteranë të Grupit Komunist të Korçës me kulturë të shëndoshë evropi-

anoperëndimore

Gjatë ditëve të prillit 1939, kur trupat fashiste italiane pushtuan Shqipërinë, Ymer Dishnica me shokë, emigrantë, puntorë dhe studentë shqiptarë që bëheshin disa qindra, organizuan manifestime të fuqishme dhe shkruan pamflete të fuqishme në gazetatat dhe revistat e emigracionit shqiptar dhe atij të huaj sidhe botuan në shtypin antifashist francez. Duke qenë një nga aktivistët veteranë të Grupit Komunist të Korçës me kulturë të shëndoshë evropi-anoperëndimore që mbante lidhje të rregullta me Atdheun, kthehet në Korçë si mjek i kualifikuar por edhe si antifashist me përvojë, hap klinikën e tij mjekësore private para se sa të themelohej PKSh. Në këtë klinikë kryheshin më shumë aktivitete politike antifashiste klandestine dhe takime pune partie me antarët e grupeve atdhetare, se sa vizita mjekësore.

Kishte filluar LANÇ e popullit shqiptar për jetë a vdekje. Shumë shpejt policia sekrete e pushtuesve ra në gjurmët e aktivitetit politik të doktor Ymerit, kështu ai ishte i detyruar të kalonte në ilegalitet të thellë. Angazhohet në një aktivitet shumë të dendur e të rrezikshëm si kuadër kryesor në veprimtarinë drejtuese të Qarkut të Korçës dhe në këtë kohë u kooptua si antar i KQ të PKSh. Në Konferencën e Parë ANÇ të Pezës më 16.09.1942, Ymer Dishnica si delegat i PKSh, luajti një rol të rëndësishëm organizativ, sidomos në marrëdhëniet e ndërsjellta me personalitetet nacionaliste. Në Pezë ai u zgjodh antar i Këshillit të Përgjithshëm ANÇ të Përkohëshëm. Ymer Dishnica gjatë kësaj kohe shpalosi fuqishëm të gjithë talentin e kapacitetet e tij intelektuale dhe organizativo-teorike.

Në Konferencën e Parë të Vendit të PKSh (1943) u shqua për zotërimin e aftësive oratorike brilante.

Më 4.7.1943 në Labinot të Elbasanit, doktori zgjidhet antar i Shtabit të Përgjithshëm të UANÇSh.

Në mbledhjen e rëndësishme të Mukjes, në muajin gusht të vitit 1943, Ymer Dishnica, Mustafa Gjinishi dhe një delegacion i gjerë përfaqësonte forcat e majta dhe Frontin NÇ, kurse Ballin Kombëtar e krysonte Mitat Frashëri dhe një deleg-

Vijon në faqen 3



KUJTIME

Dr. Ymer Dishnica dhe Mukja, gusht 1943

Kujtime të Nexhip Vinçanit



Lidhur me problemin e “Mukjes”, marrëveshja dhe prishja e saj, gjithnjë më ka bërë të mendohem dhe të rezervoj dyshime që nga ajo kohë.

Kam qënë i pranishëm rastësisht, kur në Vithkuq në bazën ku ishin E.Hoxha dhe M. Popoviç, aty nga 10-15 Gushti i vitit 1943, sollën një trakt të hedhur në Korçë nga Balli Kombëtar në të cilin ishte botuar teksti i marrëveshjes së “Mbledhjes së Mukjes”, e firmosur nga përfaqësues në këtë mbledhje: Balli Kombëtar, Fronti Nacionalçlirimtar, Legaliteti.

Menjëherë E. Hoxha ja dha Miladinin duke i thënë përmajtjen e traktit. Miladini reagoi shumë ashpër ndaj kësaj marrëveshje dhe mbas tij dhe Enveri. Aty për aty u bë një reagim (përgjigje) sipas së cilës kjo marrëveshje nuk pranohej, probleme këto të njohura historikisht. Ajo që më ka bërë të mendohem dhe të rezervoj dyshime, lidhet me sa vijon: “Kur problemi ka qënë kaq i rëndësishëm, përse nuk shkoi vetë E. Hoxha në këtë takim, por dërgoi të tjerë, Ymer Dishnicën dhe Mustafa Gjinishin?” Mos ishte me e domosdoshme prezenca e tij në përgatitjet për inagurimin e Brigadës së Parë? A mund të besohet se Y. Dishnica dhe M. Gjinishi të firmosnin një dokument të tillë, pa patur parasysh mendimet dhe porositë paraprake të E.Hoxhës? Këto dy tre pyetje më ngacmonin të gjykoj: A mos ka në këtë mes ndonjë hile? Mos, ndoshta, për Enverin e Miladinin, mos-marrëveshja ishte paravendosur prej tyre. A mos ishte mendimi që, me këtë rast të “digjeshin” Ymeri e Mustafai? (dihet që ky i fundit është dyshuar si agent i anglezëve). Veç kësaj edhe një problem tjetër më ngacmonte: Ymer Dishnicën e kam dashur e më ka dashur shumë. Për mua ai ishte me të vërtetë një intelektual më i zoti se Enveri dhe sipas mendimit tim ai ishte një udhëheqës me peshë për të ardhmen e Shqipërisë. Më vinte keq që ky njeri sfidohej e lihej në baltë, duke e diskretituar atë. Shoh këtu prapaskena që i paguan Shqipëria, populli dhe partiotët e ndershëm. Koha do t'i vërtetonte plotësisht këto dyshime, si ato të Qershorit për “Shtabin Ballkanik”, ashtu dhe tani, po luhej karta e Jugosllavisë dhe po bëhej “kurban” Shqipëria.

Vite më vonë, kur Y. Dishnica punonte si mjek dhe e pyesnin banorët për njerzillëk se si ishte me shëndet, thoshte me humor: “Jam shumë i sëmurë, vuaj nga një sëmundje e rrallë dhe e pashërueshme që quhet “Sëmundja e Mukjes”!

Dr. Ymer Dishnica - “NDERI I KOMBIT”, i sakrifikuari i madh

Vijon nga faqja 2

acion po aq i gjerë sa ai i Frontit NÇ. Ata biseduan gjerë e gjatë për problemet e Luftës së përbashkët kundër pushtuesit dhe Shqipërisë etnike, çka binte ndesh me synimet e Miladin Popoviçit dhe Dushan Mugoshës si emisarë të PK Jugosllave dhe J.B.Titos pranë KQ të PKSh që drejtonte Luftën në Shqipëri. Pikërisht për qëndrimin korrekt në këtë mbledhje, u akuzua për oportunizëm dhe u ndëshkua vetëm doktor Dishnica, ndonëse delegacioni i majtë përbëhej edhe nga disa personalitete me shumë influence të LANÇ-it. Ai i qëndroi besnik platformës së miratuar me kohë nga KQ i PKSh. Gjithsesi, LANÇ-i vazhdonte e ky personalitet i mençur dhe i shqur i saj, vazhdonte të militonte, tejet i angazhuar, në organet e LANÇ-it. Ai drejtonte sektorët që i ishin ngarkuar dhe së bashku me mikun e tij të zemrës profesor Sejfulla Maleshova, i jepnin gjallëri dhe hare çdo tubimi apo aktiviteti politik të LANÇ-it me qëndrimin e tyre gazmor dhe intelektual. Në Kongresin e Parë Antifashist Nacional Çlirimtar të Përmetit (maj 1944), u zgjodh antar i Komitetit Antifashist Nacional Çlirimtar për shëndetësinë, që kishte atributet e një Qeverie të Përkohëshme Popullore. Më 22 tetor 1944, në qytetin e Beratit u emërua ministër i Shëndetësisë i Qeverisë Demokratike të Shqipërisë e cila hyri në Tiranë e çliruar më 28 nëntor 1944.

Paralel me punët dhe aktivitetin e përditshëm që ishte shumë i ngjeshur sepse në Shqipëri po ngrihej gjithçka nga e para në jetën sociale. Së bashku me profesor Sejfulla Maleshovën, doktor Ymer Dishnica, Dhimitër Shuteriqi, poetin Mark Ndoja, publicistin Shefqet Musarai, shkrimtarin Petro Marko por edhe me At V. Prenushin, Andrea Xegën, Dhimitër Paskon, Nexhat Hakiun, Sterjo Spasen, Vedat Kokonën, Selaudin Toton etj, një pjesë e të cilëve më pas u burgosën dhe u persekutuan, krijuan për herë të parë në Shqipëri, Lidhjen e Shkrimtarëve dhe morën vendim të botohej revista “Bota e Re”, “Letërsia jonë” etj. Kjo bashkësi ishte me prejardhje jo vetëm nga PKSh dhe LANÇ

por dhe nga e majta sepse deri atëherë ishte treguar një qëndrim sektar, çka ishte e vërtetë. Pikërisht ato ditë, Sejfulla Maleshova së bashku me doktor Ymer Dishnicën, pritën deri në mesnatë, në sallën e kinema Kosovës, shkrimtarin sovjetik me famë botërore Ilia Erenburg, të cilin e shoqëronte dramaturgu fërnigjisht folës Hetem Haxhiademi. Por kjo shkëndijë demokracie dhe lirie sociale siç ishte Lidhja e Shkrimtarëve të Shqipërisë, Sindikatat apo bashkimet Profesionale, Shoqata e Miqësisë Shqipëri-Rusi e cila fillimisht kishte kryetarë: Zëvendëskryeministrin shqiptar gjeneral lejteat Koçi Xoxe, antarin e Byrosë Politike Nako Spiru, Hysni Kapo, Tuk Jakova e të tjerë, u mbyt shumë shpejt nga regjimi diktatorial.

Dr.Ymer Dishnica ishte i papajtuar me diktatorin. Me E. Hoxhën, divergjencat e doktor Dishnicës kishin filluar shumë herët dhe ishin të papajtueshme. Diktatori njerëzit si personalitetet e tipit të Y.Dishnicës, me një integritet dhe pavarësi mendimi shembullore, nuk mund t'i duronte si bashkëpunëtorë, ndaj edhe i eliminoi apo i sakatoi fizikisht një nga një, por nuk mundi kurrë t'i mposhtë moralisht as atëherë kur i burgosi për një kohë të gjatë apo i pushkatoi fizikisht. Doktor Dishnica si rezultat i aktivitetit të tij të jashtëzakonshëm antifashist dhe luftarak, ka qënë i zgjedhur deputet i Kuvendit Popullor që në legjislaturën e parë dhe i nderuar me shumë dekorata urdhëra dhe medalje të RPSH dhe të vendeve të tjera aleate.

KALVARI I MUNDIMSHËM I DR.YMER DISHNICËS

Në vitin 1947, Ymer Dishnica, për shkaqe thjesht politike, shkarkohet nga detyra e ministrit të Shëndetësisë dhe lihet në dispozicion të ministrisë së Punëve të Jashtme në një punë të dorës së fundit. Me dëshirën e tij, doktori heq dorë përfundimisht nga politika, veshi bluzën e badhë të mjekut patolog dhe filloi punën në spitalin e Tiranës (1948) dhe punonte si pedagog në shkollën e mesme mjekësore. Më 2 janar 1950, me vendim të posaçëm dëbohet

familjarisht nga Tirana për në Berat ku punoi si drejtor i Drejtorisë të Shërbimit Shëndetësor, në spital dhe në ambulancën e qytetit. Në qershor të vitit 1955, për ironi të fatit, me porosi të vetë kreut të piramidës partiake, arrestohet dhe dënohet me gjashtë vjet heqje lirie me akuzën për agjitacion e propagandë kundër shtetit!!! Pas një viti, me ndërhyrjen e njeriut që ndihmoi shumë financiarisht për krijimin e PKSh, xhaxhait të tij Esat Dishnica, i falet dënimi i mbetur (!), por kjo “falje” u shoqëru me një tjetër vendim çnjerëzor të Komisionit të Dëbim-Internimeve. Ky organizëm vrastar stalinisto-enverist e internon doktor Dishnicën në qytetin e Beratit për një afat pesë vjeçar. Y. Dishnica, ndonse i internuar, pra i persekutuar politik, ishte njeriu më i vlerësuar, më i respektuar nga populli i thjeshtë i qytetit dhe pacientët e tij të shumtë. Gjithsesi, ai mbeti familjarisht atje ku ishte, i izoluar dhe i mbikqyrur ashpër nga organet e Sigurimit të Shtetit, deri në kohën e përmbysjes të diktaturës së Enver Hoxhës dhe klikës së tij. Doktor Dishnica, ndërkohë ishte shumë i kujdeshëm, studionte dhe lexonte literature profesionale të përparuar të kohës, por edhe i ndiqte me vëmendje e kujdes situatat politike të kontinentit. Ai, gjithsesi e ndjente shpresën e madhe të demokracisë dhe liria politike dhe sociale, e cila me gjithse me shumë vonesë, po vinte më së fundi edhe në Shqipëri. Personaliteti i madh shqiptar Y. Dishnica, mendi më së fundi të kthehet i lirë në Tiranë në vitin 1995, i lodhur por optimist. I përndjekur, por i pa përkulur nga shtypja e gjatë.

Në vitin 1994, me gjith moshën jo të re, zgjidhet kryetar i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të Popullit Shqiptar.

I nderuari Y. Dishnica vdiq në gjirin e familjes i qetë dhe i respektuar nga familjarët, të afërmit, miqtë, shokët, veteranët dhe luftëtarët e LANÇ-it më 22.9.1998. Shoqëria shqiptare humbi kështu një njeri emblemantik, të edukuar, të shkollur, të përkushtuar dhe të kulturuar në shkallën më sipërore që do të kujtohet për një kohë shumë të gjatë dhe do të zerë vendin e merituar në panteonin e nderit të kombit shqiptar.

PËRKUJTIMORE

Një vit që Ai s'është fizikisht mes nesh, por shpirtërisht ai është me ne në çdo çast, pasi vepra e tij heroike e veshi atë me pavdekësi

Një vit pa gjeneral Parllakun

HALIL RAMA

Një vit më parë më 15 shtator 2019 pushoi së rrabri zemra e heroit legjendar Rrahman Parllaku. Një ditë më pas (16 shtator) ai u përcoll për në botën e përtejme me të gjitha nderimet që meritonte një burrështetas si Ai, me arkivolin mbi shtratin e topit dhe me 22 të shtënat në çastin e lamtumirës të tij.

Një vit që Ai s'është fizikisht mes nesh, por shpirtërisht ai është me ne në çdo çast, pasi vepra e tij heroike e veshi atë me pavdekësi.

E përbashkëta e qindra mesazheve të personaliteteve publike e politike, si dhe qytetarëve të thjeshtë nga Shqipëria, Kosova e diaspora, në librin e ngushëllimeve që Protokolli Zyrtar i Shtetit hapi në ceremoninë e lamtumirës së gjeneral Parllakut, (para një viti) është atdhedashuria si i vetmi testament që na la "Heroi i Popullit" dhe "Nderi i Kombit".

"Nëse dikush duhet quajtur sfidant i kohërave, ky është pa asnjë dyshim gjeneral Rrahman Parllaku. E sfidoi varfërinë në bjeshkët e Sharrit, sfidoi pushtimin e vendit me armë, shpirt e zemër; luftoi për çlirimin e Shqipërisë, sfidoi diktaturën dhe u la brezave një shembull të madh virtyti dhe idealizmi". Do të mjaftonte qoftë dhe vetëm ky shënim në librin e ngushëllimeve, i dy personaliteteve të letrave dhe politikës, Arta Dade e Namik Dokle, për të profilizuar gjeneralin legjendë në kufirin e tri kohëve. Por në qindra mesazhet e ngushëllimeve për gjeneralin që "u fik në paqe dhe iku në këmbë" (siç shprehet gjeneral Piro Ahmetaj), kupton fare lehtë se ai iku duke i lënë familjes, bashkëluftëtarëve e bashkëpunëtorëve, shokëve e miqve në gjithë hapësirën mbarëshqiptare të vetmin testament, atë të atdhedashurisë...

Gjeneral Parllaku ishte ndër të paktët partizanë që jetoj dhe dëshmoi histori të tri kohëve, të partizanit e luftëtarit antifashist, heroit e komandantit ushtarak dhe atë të persekutimit komunist.

Ai ia doli mbi të gjitha furtunat e jetës, doli fitimtar nga Lufta Antifashiste, doli gjallë nga burgu komunist, doli fitimtar në luftën për pavarësinë e Kosovës dhe deri para një jave ishte gjenerali më i vjetër, por me mendje të re, që mbështeste anëtarësimin e Shqipërisë dhe të ushtrisë shqiptare në NATO dhe integrimin e saj në BE.

Para 18 muajsh, me rastin e 100-vjetorit të lindjes, Bashkia e Tiranës e nderoi atë me titullin "Simbol i qytetit të Tiranës". Kryebashkiaku Veliaj e vlerësoi Parllakun si një nga figurat emblematiche të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që sfidoi edhe regjimin e diktaturës komuniste, si simbol i gjallë i kujtesës pa-



Gjeneral Parllaku me dy mbesat

triotike, qytetare dhe historike. Dhe në të vërtetë, ai që kthyer në simbol të gjallë të kujtesës patriotike, qytetare dhe historike.

Shqiptarët ndihen krenarë me jetën dhe veprën e "Heroit të Popullit" dhe "Nderit të Kombit", që bëri gjithçka në shërbim të atdheut e kombit. Prandaj, edhe vlerësimet dhe nderimet ndaj veprës së gjeneralit janë plotësisht të merituar.

Me gjeneral Parllakun, ndihemi krenarë të gjithë. Ai ishte dhe mbetet përmendore e gjallë e traditës dhe e virtytit familjar të trashëguar ndër shekuj.


Opinion i publik ka mirëpritur edhe librat e ndryshëm të shkruar nga gjenerali, siç është ai me titull: "Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre", "Kosova, ëndrra e jetës sime", dhe librin me shtatë kapituj në 466 faqe "Një shekull në memorie".

Me një kujtesë të jashtëzakonshme, me një mendjemprehtësi të madhe, gjeneral Parllaku ka bërë analiza brilante të situatave të vështira e delikate që ka kaluar vendi dhe ushtria jonë. E veçanta e gjithë "ligjëratave" të tij në shtypin e kohës dhe në veprimtari promovuese të librave kushtuar Luftës Nacionalçlirimtare e heronjve të saj, ka qenë gjykimi i tij tepër i saktë, konciz, realist, pa mllëfe, pa paragjykime... Ai e ka vlerësuar gjithnjë lart Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, arritjet dhe përpjekjet e popullit jo vetëm në rindërtimin e Shqipërisë së pasluftës, por edhe ato në fushën e arsimit, shërbimit shëndetësor, zhvillimit në tërësi të vendit, përfshirë edhe arritjet në mbrojtjen e fuqizimin e ushtrisë...si dhe këto vite të demokracisë e pluralizmit.

NGA JETA E KËTIJ MATUZALEMI NA ULET KËMBËKRYQ HISTORIA

Nga jeta e këtij Matuzalemi na ulet këmbëkryq historia. Nga lufta dhe përkushtimi i tij atdhetar na vjen një model për t'u ndjekur... Nga veprimtaria e gjeneral Parllakut si veteran në këtë çerek shekulli të demokracisë mund të mësojmë se kurrë nuk është vonë për njeriun që të bëhet mbështetës aktiv i proceseve demokratizuese të shoqërisë.

Në spiralet e historisë, gjeneral Parllaku ka ditur të



lakohet me dinjitet, duke pasur si kolonë bazë përkushtimin kombëtar shqiptar dhe progresin shoqëror, si thelb i motivimit që gëllonte shpirtin e tij progresist e lirishtashës. Vështirë të përmbledhësh në pak radhë, në kuintesencë, motivimin e personalitetit të tij, zhvillimin konjitiv e psikomotor të këtij djaloshi që ngjitej nga Novosej i Kukësit në Tribuna të larta shtetërore, në hero të popullit të tij, në drejtues madhor ushtarak, duke ndryshuar variablat në kontekste politike në funksion të mbijetesës dhe qëndresës, nga udhëheqës i shquar në të dënuar me burg, nga triumfator në grigjë të rrezikut për jetën, nga piedestali i kuadrut të dobishëm në stigmën e "njeriut të rrezikshëm", ekstreme këto që provokuan në personalitetin e tij, qëndrime dhe vlera të larta politiko-shoqërore në raportin e ndjenjave të forta estetike midis dashurisë dhe urrejtjes. Këtë volum ideor dhe estetik e përcjell përgjatë shekullit të jetës së tij, një burrë shtetar, një organizëm vital, një mendje koherente dhe një vizion largpamës dhe perspektiv.

HEROI QË FITOI DUKE MERITUAR LAVDINË DHE PAVDEKËSINË

Retrospektiva dhe perspektiva kanë një prerje të artë në personalitetin e gjeneral Parllakut, atë e përsërkon frymëzimi dhe dashuria për atdheun e tij, si lajtmotiv vijues mbikohor, që çliron në rrethana tipike energji shpirtërore pozitive në luftën e jetës. Jeta e tij është një shembëlltyrë e rrallë që na fton të kuptojmë se jeta meriton të jetohet kur luftohet fort dhe fitohet. Si një ushtarak, korrekt, i shquar, ai mbështetej në skrupuj të fortë të moralit kombëtar, me pikëvështrim të qartë dhe të kthjellët, duke ngjitur një nga një shkallët e karrierës ushtarake, si një gjigant hijerëndë që ngjitet i sigurt në bedenat e kalasë. Kalaja e pushteteve në kohë të ndryshme dhe situata të ndryshme, pati edhe shembje morale e politike, por këto nuk e dobësuan dhe përlënë gjeneral Rrahman Parllakun, këtë soj të fortë shqiptari, që me mençuri diti të manovrojë në spiralet e rrezikshme të historisë shqiptare.

Heroi i luftës në terren, i luftës dhe përbaljes në

(Vijon në faqen 5)

Halil Rama
Sakip Cami



RAHMAN PARLLAKU
Gjenerali që sfidoi kohërat

BOTIMET M&B



PERSONAZH

Ka botuar tre libra: “Mirënjohje për familjet vlonjate që më mbajtën si birin e tyre”, “Kosova e lirë, ëndrra e jetës time” dhe “Një shekull në memorie”



“NDERI I KOMBIT” Rrahman Latif Parllaku (17 prill 1919 - 15 shtator 2019)

Rrahman Parllaku, i biri i Latif Parllakut dhe Kadimes, lindi në fshatin Novosej të Lumës, më 17 prill 2019. Shkollën fillore e kreu në Shishtavec. Në moshën 12-vjeçare ka filluar punë me babanë dhe vëllanë në profesionin e pastičierit nga viti 1932 në Cakran të Mallaklastrës dhe nga viti 1936 në Selenicë të Vlorës.

U kthye përsëri për të vazhduar shkollën dhe për të dhënë provimet. Me ndihmën dhe këmbënguljen e mësuesit të tij Salih Kolgeci, dhe të drejtorit të shkollës Myslim Sina nga Tërbaçi i Vlorës, arrin ta përfundojë arsimin fillor 5 vjeçar.

Më 1930, babai i Rrahmanit, Latifi, së bashku me të vëllain u largua për në Vlorë dhe Cakran të Mallaklastrës. Nga viti 1936 deri në vitin 1939, Rrahmani punoi në Selenicë të Vlorës.

Në prag të pushtimit fashist të 7 prillit 1939 me vëllanë Selimin kushëririn Baftjarin bashkë me popullin e Selenicës zbritën në Vlorë për të kërkuar armë për të mbrojtur vendin nga pushtimi fashist. Të zhgënjyer e dëshpëruar nga qëndrimi i mbretit dhe qeverisë, që nuk e armatosën e organizuan popullin për luftë kundër fashizmit, u kthyen në Selenicë. Në nëntor 1939, hapën një lokal pasticieri në qytetin e Vlorës.

Në protestën e zhvilluar më 28 nëntor 1941 kundër pushtuesve iu dha rasti që në kulmin e entuziazmit të protestuesve të dalë në krye për të mbajtur flamurin kombëtar që përpiqeshin ta rrëmbenin fashistët, aty mori një goditje në kokë. Pas kësaj dite përfshihet në njësitet guerile të qytetit, fillimisht guerilas i thjeshtë, pastaj përgjegjës grupi e njësi

dhe me pranimin si anëtar i Partisë Komuniste.

Më 6 janar 1943 u caktua komandant i njësiteve guerile të qytetit të Vlorës deri më 28 nëntor 1943, kur e transferuan me detyrë komisar batalioni. Pas rezultateve të mira në drejtimin e batalionit në luftimet kundër forcave naziste dhe ruajtjen e kompaktësisë të efektivit gjatë Operacionit armik të Dimrit 1943-1944, emërohet zëvendëskomisar i Brigadës së 8-të, e përvuar më 26 prill 1944 në Sheper të Gjirokastrës. Gjatë muajit maj u mor me organizimin e Brigadës së 12-të Sulmuese dhe mbrojtjen e Kongresit të Përmetit.

Më 8 qershor 1944 transferohet në Brigadën e 3-të Sulmuese dhe së bashku me anëtarët e shtabit që drejtonin këtë njësi përballoi me sukses Operacionin e qershorit të ushtrisë naziste. Pas këtij operacioni me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, brigada kalon në Shqipërinë e Mesme, me detyrë të spastrojë nga armiqtë zonat malore të Elbasanit e Tiranës e të sigurojë nga shpina forcat e Divizionit të 1-rë, që vepronin në Mat e Dibër dhe të mbronin bazën e Bizës, ku hidhnin materiale avionët aleatë. Në fillim të shtatorit, brigada me urdhër të Komandës së Përgjithshme mori për detyrë që së bashku me Brigadën e 5-të të kalonin në Kosovë për të shpejtuar çlirimin e kësaj zone e të ndihmonin në ngritjen e Këshillave Nacionalçlirimtare si organe të pushtetit të ardhshëm për përfshirjen në masë të kosovarëve në luftë për t'ju bashkuar frontit antifashist të popujve dhe të dëmtonin e pengonin forcat gjermane në tërheqje. Me çlirimin e Kosovës, më 22 nëntor, në

qytetin e Pejës merr urdhrin e emërimit komandant i Divizionit të 5-të dhe u gradua kolonel.

Nga 20 dhjetori i vitit 1944 deri në mars të vitit 1945, forcat e komanduara nga Parllaku në bashkëveprim me forcat jugosllave çliruan krahinën e Sanxhakut. Me ndërprerjen e luftimeve, forcat e Divizionit të 5-të e të 6-të Sulmues u kthyen në Kosovë.

Më 14 prill të vitit 1945, kur ndodhej në Mitrovicë, ai mori urdhrin e emërimit komisar i Korparmatës së 2-të në Berat. Me shkrijen e saj e nxorën në lirim dhe e caktuan sekretar politik i Komitetit Qarkor të PK të Shkodrës.

Me kërkesën e tij rikthehet në ushtri në detyrën e drejtorit të Personelit në Ministrinë e Mbrojtjes. Në vitin 1947 i jepet grada kolonel.

Në dhjetor të vitit 1947, Parllaku u caktua në detyrën e drejtorit Politik të Ushtrisë, detyrë të cilën e kreu deri në prill të vitit 1948, kur u dërgua të studionte jashtë shtetit.

Parllaku ka mbaruar studimet në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Sovjetike “Voroshilov”. Pas kthimit nga studimet, ai u emërua drejtor i Drejtorisë së Organizim-Mobilizimit në Ministrinë e Mbrojtjes.

Në vitin 1952-1954 caktohet në postin e zëvendësministrit të Mbrojtjes e drejtor i Prapavijës së Ushtrisë dhe mori gradën e lartë të gjeneral-majorit.

Gjatë viteve 1954-1961 do të shërbente si zëvendësministër i Mbrojtjes për përgatitjen luftarake të ushtrisë.

Nga viti 1961 deri në vitin 1967 kreu detyrën e komandantit të Forcave Ushtarako-Detare dhe më pas komisar i

këtyre forcave dhe iu dha grada gjeneral-leitnant.

Në vitet 1969-1970 do të shërbente si komisar i Forcave Ushtarako-Ajrore dhe një vit më vonë u emërua zëvendësministër për Përgatitjen Luftarake të Ushtrisë.

Për merita të veçanta i është dhënë titulli “Hero i Popullit” dhe është dekoruar me 9 urdhra e tri medalje të luftës dhe 3 urdhra të shërbimit ushtarak. Parllaku, ka qenë zgjedhur deputet i Kukësit në Kuvendin Popullor për 7 legjislatura rresht, që nga viti 1945 deri në vitin 1973.

Gjeneral Parllaku ka qenë kandidat i KQ të PKSH që nga tetori i vitit 1944 deri në Kongresin e Parë. Në kongresin e Katërt rizgjidhet përsëri kandidat i KQ të PPSH dhe në Kongreset e Pestë e të Gjashtë anëtar i këtij Komiteti.

Parllaku u arrestua dhe dënua për pjesëmarrje në të ashtuquajturin “puç ushtarak”, nën akuzën e “krimit dhe tradhtisë ndaj atdheut, sabotimit dhe agitacionit dhe propagandës me rrezikshmëri të lartë”. Në bazë të këtyre akuzave u dënua me 25 vjet heqje lirie, nga të cilat 16 vjet e tri muaj i vuajti në burg (nga dhjetori i vitit 1974 deri më 17 mars të vitit 1991), si pjesëtar i të ashtuquajturit “grup i Beqir Ballukut”. Duke pasur akuzën e rëndë të “tradhtisë ndaj atdheut”, të ashtuquajturit pjesëtarë të këtij grupi: Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako e Rrahman Parllaku nuk amnistoheshin nga ligjet në fuqi.

Në rekursin e bërë nga Parllaku, Gjykata e Kasacionit vendosi, më 20 korrik të vitit 1994, prishjen e vendimit të 5 nëntorit të vitit 1975 të Gjykatës Ushtarake, që i cilësoi fajtorë ushtarakët e lartë, dhe pushimin e akuzave të mësipërme.

Ai ishte kryetar i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës të Popullit Shqiptar, të cilën e drejtoi me devotshmëri e përkushtim për 20 vjet.

Ka botuar tre libra: “Mirënjohje për familjet vlonjate që më mbajtën si birin e tyre”, “Kosova e lirë, ëndrra e jetës time” dhe “Një shekull në memorie”.

Në 95-vjetorin e lindjes, i është dhënë nga Presidenti i Republikës dekorata e lartë “Nderi i Kombit”.

U nda nga jeta më 15 shtator 2019, në moshën 100 vjeçare.

Një vit pa gjeneral Parllakun

(Vijon nga faqja 4)

gjyqe ushtarake, përballoi burgje e privime dhe fitoi duke merituar lavdinë dhe pavdekësinë. Jeta iu afrua Heroit herë me tufa me lule, herë duke u derdhur mbi të me tërë egërsinë e saj. Rrallë gjen shembuj të tillë të personalitetit, ku të jenë ngjizur e plazmuar në mënyrë aq mjeshtërore vetitë e karakterit të një intelektual patriot, të një drejtuesi e komanduesi të aftë ushtarak, të zgjuar dhe trim, të thjeshtë dhe të ndershëm, të bukur në trup, shpirt dhe mendime.

Ai është një model i ardhur nga genocidi komunist si dëshmitar i gjallë për të kuptuar dhe vërtetuar peripecitë dhe traumat që kaloi ky popull i orientuar dhe i ideologjizuar gabimisht nga rryma dhe korrente të huaja.

Mbi 20 vjet në krye të Shoqatës së Veteranëve të Luftës, me ndershmëri dhe principe të larta morale, ka kontribuar në ndriçimin e mjaft skenave dhe protagonistëve, të vërtetave dhe kërtimeve historike, duke dhënë edhe në moshë pensioni, një ndihmesë të vyer në emancipimin politik-shoqëror e demokratik të shoqërisë. Si një

lundërtar i shquar, ai e drejtoi varkën e shpëtimit duke kapërcyer me sukses tallazet e historisë deri në brigjet e paqta të demokracisë që po jetojmë. Jo vetëm gjatësia kohore e jetës, por dendësia dhe përmbushja e saj me vprime, qëndrime dhe vlera në përmbajtjen e saj, e bën këtë figurë të lartësuar në nderimin tonë shoqëror, ku zëri dhe mesazhet e tij dëgjohen deri në organizata famoze ndërkombëtare. Në këtë vështrim, gjeneral Rrahman Parllaku përbën një shembull frymëzimi për atdhedashurinë dhe përkushtimin qytetar.

16 SHTATORI

Konferenca e Pezës është një ngjarje madhore që na fton të gjithëve të bashkëpunojmë sa më ngushtë në respekt të historisë

Presidenti META: Pezë për shqiptarët do të thotë bashkim



Nga Muharrem GJOKA
Nënkryetar i OBVL

Çdo 16 shtator, veteranët e OBVL, përfaqësues të legjislativit, ekzekutivit dhe qeverisjes vendore vijnë në Pezë dhe përkulen me nderim në këtë vend të shenjtë për të gjithë shqiptarët. Sepse, siç është shprehur Presidenti I Republikës SHT Z.Illir Meta: “Pezë për shqiptarët do të thotë bashkim, qëndresë, dhe besa-besë me parullën historike që lindi këtu dhe që nuk mund të mbetet vetëm histori, por që është edhe një amanet që gjithë shqiptarët të bashkohen pa dallim feje, krahine dhe ideje për interesin kombëtar. Peza në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe e ekspozuar ndaj pushtuesit, u dogj, u masakrua si asnjë krahinë tjetër, por asnjëherë nuk u dorëzua”. Në vlerësim të veprës dhe kontributit të Babë Myslimit, kreu i shtetit shqiptar shprehet se: “Përkulemi para veprës dhe kujtimit së patriotit të paharruar Myslim Peza, i cili bujti këtë Konferencë e cila është historike sepse në një kohë të errët të pushtimit ishte Konferenca e parë pluraliste në vendin tonë e cila dha mesazhe të fuqishme të patriotizmit dhe të ngritjes mbi interesat parciais për interesin e madh kombëtar”.

Konferenca e Pezës është një ngjarje madhore që na fton të gjithëve të bashkëpunojmë sa më ngushtë, jo vetëm në respekt të historisë, por edhe të ruajtjes së atyre vlerave e trashëgimie për ta investuar për edukimin patriotik të fëmijëve tanë. Në mënyrë që të gjithë ta kuptojnë se sa ka arritur Shqipëria përmes sakrificave sublime të paraardhës tanë. “Peza nuk është mund të mbetet vetëm histori, por është amaneti i gjithë dëshmorëve që dhanë jetën për të realizuar vendimin madhor të Konferencës së Pezës për bashkimin e shqiptarëve për çlirimin e Shqipërisë. Sot objektivi ynë kombëtar është integrimi i Shqipërisë, ndaj është koha për të mos e vonuar më këtë proces për shkak të antagonizmit politik të parpinciptë, por është koha për të forcuar bashkëpunimin duke lënë mënjanë interesat afatshkurtra të ngushta në mënyrë që e ardhmja evropiane e Shqipërisë të jetë sa më e shpejtë, sa më e prekshme për fëmijët tanë”, është shprehur Presidenti Meta.

KONFERENCA E PEZËS DHE ROLI I SAJ NË LUFTËN NACIONAL ÇLIRIMTARE

Protagonistë të këtij kuvendi ishin 20 delegatë përfaqësues të krahinave

dhe besimeve të ndryshme fetare

Më 16 shtator 1942 u mbajt Konferenca e Pezës e cila pati për qëllim organizimin e forcave të ndryshme politike në një luftë të përbashkët kundër Italisë fashiste. Kë vonë ky organizim mori emrin Fronti Nacional-Çlirimtar, Konferenca e Pezës u mbajt në Pezë, një fshat pak kilometra distancë nga Tirana. Protagonistë të këtij kuvendi ishin 20 delegatë përfaqësues të krahinave dhe besimeve të ndryshme fetare, klasa dhe shtresa me bindje politike nga më të ndryshmet. Pjesëmarrësit vinin nga rryma të ndryshme politike.

Ndërmjet tyre ishin: Abaz Kupi, Aziz Çami, Halim Begeja, Haxhi Lleshi, Ismail Petrela, Mustafa Khani, Myslim Peza, Ndoc Çoba, Ramazan Jarani, Skënder Jegeni dhe Skënder Muço. Nga PKSHP morën pjesë Ymer Dishnica, Mustafa Gjinishi, Koço Tashko, Enver Hoxha, Nako Spiru dhe Nexhmije Xhuglini (më vonë Hoxha). Kryetar i konferencës u zgjodh Ndoc Çoba dhe sekretar, Mustafa Gjinishi.

Në konferencë u diskutua organizimi i forcave në një luftë të përbashkët kundër okupatorit, organizim ky që mori emrin më vonë, Fronti Nacional-Çlirimtar.

Të pranishmit hynë në debate në lidhje me simbolet komuniste, si ylli i kuq, i cili nuk pranohej nga jekomunistët. U miratua një rezolucion, në të cilin thuhej se përfaqësuesit e të gjitha tendencave nacionaliste, PKSHP-së, Rinisë Komuniste, Rinisë Nacionaliste dhe Rinisë Femërore Popullore, miratonin deklaratën përkatëse ku përkrahej koalicioni kundër boshtit, akuzohej rëndë Mustafa Kruja dhe përkrahej lufta e atyre çetave që kishin luftuar deri ato momente, duke i dhënë rëndësi, nga ana tjetër, çështjes së këshillave nacionalçlirimtare. Rezolucioni i Konferencës së Pezës.

Delegatët e ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, përfaqësuesit e gjithë tendencave të nacionalizmit shqiptar, të Partisë Komuniste, të Rinisë Nacionaliste, të Rinisë Komuniste dhe Rinisë Femërore Popullore të Shqipërisë, të udhëhequr nga qëllimi i shenjtë për çlirimin e Shqipërisë nga thundra e Italisë fashiste dhe nga tradhtarët e shitur tek i huaji, mbasi përkujtuan dëshmorët e rënë në luftë kundër fashizmit, mbasi shqyrtuan mirë gjendjen shqiptare dhe veçanërisht, mbasi theksuan dëshirën dhe nevojën për organizimin e të gjithë energjive shqiptare për bashkim të plotë të tyre me luftën NÇ, arritën në këto përfundime: Gjendemi në një botë të përgjakur anekënd prej forcave të errëta prej skllavëronjësve të fashizmit. Popuj e kombe u shkelën pa mëshirë prej barbarisë fashiste.

Konferenca zgjodhi Këshillin e Përgjithshëm Nacional, të përbërë nga:

- Kamber Qafmolla (kryetar)
- Mustafa Gjinishi (sekretar)
- Ndoc Çoba
- Myslim Peza
- Abaz Kupi
- Enver Hoxha
- Ymer Dishnica (anëtar)

Me përjashtim të Enver Hoxhës dhe Myslim Pezës, të gjithë të tjerët u cilësuan si tradhtarë nga historiografia komuniste, e cila përpigjej t'i jepte rolin e udhëheqësit, Enver Hoxhës.



KALENDARI

Ngjarje të rëndësishme historike gjatë Luftës së Dytë Botërore në shtatorët e viteve 1942-1945

2 shtator 1945 - Kapitulloi Japonia Fashiste.

9 Shtator 1943 - Thirrje popullit shqiptar për kapitullimin e Italisë Fashiste.

4 shtator 1943 - Në Konferencën e Partisë Komuniste në Labinot, 4-8 shtator 1943, u dënua zyrtarisht Marrëveshja e Mukjes dhe u vendos t'i shpallej luftë e armatosur Ballit Kombëtar, me të cilin pak kohë më kishin qenë partnerë, si edhe çdo rryme apo tendence tjetër politike. Për këtë arsye, Konferenca e Labinotit u quajt “momenti vendimtar drejt marrjes së pushtetit” dhe i nisjes së luftës civile në Shqipëri. Nga ky moment, lufta e armatosur ndaj kundërshtarëve politikë do të ishte prioriteti i politiksë së PKSHP dhe E.Hoxhës. Vendimi i marrë në Konferencën e Labinotit që pushteti i Këshillit NÇ të ishte pushteti i vetëm, haptë rrugën e një sistemi njëpartiak dhe të një pushteti totalitar në Shqipëri. Thelbi i të cilit qëndronte në sundimin e një partie të vetme, Partisë Komuniste.

9 shtator 1944 - U formua Brigada XX Sulmuese e UNÇI Shqiptare në fshatin Protopapë të Korçës.

9 shtator 1944 - U çlirua Bullgaria nga Ushtria Sovjetike – Përmbysja e diktaturës fashiste në Bullgari.

10 shtator 1944 - Lufta për çlirimin e Gjakovës prej gjer-manëve (10-16 shtator) nga forcat çlirimtare të Kryez-injve (Gani, Hasan dhe Sait Kryeziu), ku bënë pjesë edhe Llazar Fundo, komisar politik i Lëvizjes Kryeziu, si edhe oA ceri britanik Simkoks. Kur luftonin kundër pushtuesve gjermanë, forcat e Kryezinjve u goditën nga forcat partizane të Brigadës V të Shqipërisë dhe forcat NÇ të Jugosllavisë (Kosmetit), të udhëhequra nga Fadil Hoxha.

12 shtator 1944 - Dita e çlirimit të qytetit të Beratit.

13 shtator 1942 - U formua Çeta e Lumës

14 shtator 1943 - Filloi Lufta e Drashovicës (Vlorë) kundër garnizont armik, nga batalionet partizane “Halim Xhelo” e “Ismail Qemali, si dhe nga 4 batalione të krijuara nga vullnetarët dhe nga i gjithë populli i fshatrave të afërta.

15 shtator 1942 - Dita e çlirimit të Çorovodës.

16 shtator 1942 - Konferenca e Pezës, hapi parë për krijimin në formë organizative të Frontit NÇI, ku morën pjesë PKSHP dhe përfaqësuesit e tendencave të ndryshme të naciona-listëve shqiptarë. Konferenca e Pezës në programin e saj politik kishte: luftën e organizuarm të ashpër e pa kom-promis kundër okupatorëve dhe tradhtarëve, me parul-lën: bashkim pa dallim feje, krahine dhe ideje.

16 shtator 1944 - U formua Brigada XIX Sulmuese e UNÇI Shqiptare.

18 shtator 1944 - U formua Brigada XXII Sulmuese e UNÇI Shqiptare, në Pezë të Tiranës.

18 shtator 1944 - Dita e çlirimit të qytetit të Gjirokastrës.

20 shtator 1943 - U formua në qytetin e çliruar të Beratit batalioni “Margarita Tutulani”.

21 shtator 1944 - U formua Brigada XXIII sulmuese e UNÇI Shqiptare, në Zall-Mner të Tiranës. 22 shtator 1942 - dha jetën Heroi i Popullit Nazmi Rushiti. 22 shtator 1943- Forcat partizane të qarkut të Tiranës zhvillojnë luftime të ashpra me gjermanët për mbrojtjen e Krujës.

22 shtator 1944 - Dita e çlirimit të qytetit të Krujës.

23 shtator 1944 - Llazar Fundo, figurë e shquar e socialdemokracisë europiane, i cili, bashkë me Kryezinjët, po luftonte kundër gjermanëve për çlirimin e Gjakovës, u arrestua nga forcat e Brigadës V të Ushtrisë NÇ të ko-manduar nga Shefqet Peçi dhe u pushkatua në Kolesian pa gjyq, me urdhër të E.Hoxhës me radiogram: “Zai Fundon ta torturonin deri në vdekje dhe pastaj ta vrisni an-dej”.

25 shtator 1944 - Masakra e Brigadës V. Me urdhër të koman-dantit të saj, Shefqet Peçi, u pushkatuan pa gjyq në Krue të Bardhë të Lumës 22 lumjari të pafajshëm, të lidhur me konop me njëri-tjetrin, si hak-marrje për vrasjen e nipit të tij, Hysen Çino.2

6 shtator 1944 - U formua Brigada XVII Sulmuese e UNÇI Shqiptare, në Gjinar të Elbasanit.

DEKORIMI

Presidenti Meta dekoron 38 figura të shquara patriotike për kontributin në Luftën e Vlorës të vitit 1920

Emrat e luftëtarëve të Vlorës, me gërma të arta në altarin e kombit



Meta: “Në Njëqindvjetorin e kësaj epopeje të lavdishme e nisëm në Poçemin e besëlidhjes mallakastriote të komandant Halim Hamitit, për t’u ndalur në Kalanë e Tepelenës të Selam Salarisë nga u nisën luftëtarët e jugut , u bashkuam në Pilurin e Kolë Mërkurit dhe tani jemi mes jush në Drashovicën e çetave të lumit të Vlorës, për të vazhduar më tej në Tiranën e qeverisë së Sulejman Delvinës dhe për ta finalizuar në Vlorën e Flamurit tonë Kombëtar!”



Drashovicë, Vlorë - 27 Gusht 2020. Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta në kuadër të kremtimit të 100-vjetorit të Luftës së Vlorës zhvilloi një vizitë pune në Bashkinë e Selenicës, ku vlerësoi luftëtarë, drejtues të njërive luftarake, atdhetarë dhe patriotë të krahinës së Lumit të Vlorës, për trimërinë, patriotizmin dhe kontributin e shquar, në mbrojtje të interesave kombëtare ndaj pushtuesve italianë në vitin 1920.

Kreu i Shtetit, i shoqëruar nga Kryetari i Bashkisë së Selenicës z. Pëllumb Binaj, përfaqësues të autoriteteve vendore, drejtues të shoqatave atdhetare, dhe qytetarë, vendosi një kurorë me lule në memorialin e Drashovicës, ku u përul me mirënjohje dhe respekt para veprës dhe heroizmit të luftëtarëve të kësaj zone.

Presidenti Meta në fjalën e tij u shpreh: “Vlora e flamurit nuk mund të mos e ndante madhështinë dhe lavdinë e kremtimit të 100-vjetorit të Luftës së 1920 me Lumin e Vlorës, me Bregun e Detit, me Labërinë dhe gjithë Shqipërinë!

Edhe pse emrat e luftëtarëve të Vlorës tashmë janë shkruar me gërma të arta në altarin e kombit, do të uroja që në të ardhmen ato të skaliten në mermerin e një basorelievi madhështor si ky i Drashovicës, ku prindërit t’u rrëfejnë nipërve dhe mbesave emrat dhe historinë e luftimeve të tyre. Por, nderimi më i madh që mund t’i bëjmë kujtimit të tyre është që të gjithë bashkë të lartësojmë vendin tonë përpara kërkesave të kohës dhe zhvillimit.

Ta shndërrojmë gjithë trashëgiminë dhe potencialin njerëzor si komb në energji pozitive për evropianizimin e vendit” Ta ndërtojmë atdheun tonë të dashur për të jetuar qytetarët e vet dhe sidomos brezat që do të vijnë.

Presidenti Meta, pasi vlerësoi rëndësinë e kësaj ngjarjeje historike, trimërinë dhe patriotizmin e të gjithë popullit të kësaj zone theksoi: “Në Njëqindvjetorin e kësaj epopeje të lavdishme e nisëm në Poçemin e besëlidhjes mallakastriote të komandant Halim Hamitit, për t’u ndalur në Kalanë e Tepelenës të Selam Salarisë nga u nisën luftëtarët e jugut , u bashkuam në Pilurin e Kolë Mërkurit dhe tani jemi mes jush në Drashovicën e çetave të lumit të Vlorës, për të vazhduar më tej në Tiranën e qeverisë së Sulejman Delvinës dhe për ta finalizuar në Vlorën e Flamurit tonë Kombëtar!”

Kreu i Shtetit, në ceremoninë solemne të dekorimit të luftëtarëve të Lumit të Vlorës, ka vlerësuar edhe “Skulptorin e Popullit” Mumtas Dhrami, me dekoratën “Nderi i Kombit”, për realizimin e veprës historike të monumentit të Drashovicës.

Presidenti Meta vlerëson me “Dekoratën e Flamurit Kombëtar” vëllezërit e shquar të Rilindjes Kombëtare, Naim, Abdyl dhe Sami Frashëri

Vepra e frashërlinjve na udhëheq drejt integritetit european



Frashër, Përmet - 21 Gusht 2020. Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta zhvilloi një vizitë pune në Frashër të Përmetit, për të vlerësuar dhe nderuar me “Dekoratën e Flamurit Kombëtar”, më të lartën në Republikën e Shqipërisë, tre atdhetarët e mëdhenj të kombit shqiptar, vëllezërit Abdyl, Naim dhe Sami Frashëri, për kontributin e pazëvendësueshëm në zgjimin e vetëdijes kombëtare dhe rilindjes kulturore e letrare, në shërbim të mbrojtjes së territoreve shqiptare dhe luftës për Pavarësinë e Shqipërisë.

I shoqëruar nga Kryetaria e Bashkisë së Përmetit, znj. Alma Hoxha, autoritetet vendore, përfaqësues nga të gjitha trevat shqiptare dhe forcave politike në vendin tonë, studiues, historianë, intelektualë dhe banorë të shumtë, Presidenti Meta fillimisht vendosi kurora me lule në bustet e tre vëllezërve Frashëri dhe u përul me nderim e respekt të thellë para jetës e veprës së tyre.

Më pas, Kreu i Shtetit vizitoi shtëpinë muze të vëllezërve Frashëri, monument i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore, ku ndodhen një sërë dokumentesh që pasqyrojnë historikun e zonës dhe veprimtarinë e ndritur të tre rilindasve të shquar.

Gjithashtu, Presidenti Meta vizitoi edhe Tegenë e Frashërit, një fortesë e nacionalizmit shqiptar, me shumë ndikim tek vëllezërit Frashëri , ku u prit nga Baba Hekuran Nikollari.

Në ceremoninë solemne të organizuar me këtë rast para busteve të tre vëllezërve Frashëri, Kreu i Shtetit i akordoi Abdyl Frashërit (pas vdekjes) “Dekoratën e Flamurit Kombëtar”, me motivacionin: “Si një ndër adhetarët më të shquar në luftën për shpëtimin e trojeve shqiptare, bashkimin e popullit dhe çlirimin kombëtar të shqiptarëve.

Si ideolog i spikatur i Rilindjes Kombëtare, një ndër organizatorët kryesorë dhe përfaqësues i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, burrë shteti me vizion, politikan, diplomat e personalitet me merita të jashtëzakonshme, i cili nuk kurseu asgjë për lirinë dhe lartësimin e kombit shqiptar”.

Ndërsa Naim Frashërit (pas vdekjes), Kreu i Shtetit i akordoi të njëjtën dekoratë, me motivacionin: “Për kontributin e pazëvendësueshëm në zgjimin e vetëdijes kombëtare dhe të rilindjes kulturore e letrare, në shërbim të luftës për Pavarësinë e Shqipërisë. Si poeti kombëtar, mendimtari dhe atdhetari i shquar i Rilindjes Kombëtare. Misionari, mësuesi dhe krijuesi talentuar, i cili i këndoi me përkushtim dhe i bëri jehonë atdhedashurisë, historisë, gjuhës, kulturës, identitetit dhe lirisë së shqiptarit. Frymëzuesi i madh i krenarisë, dinjitetit dhe vetëdijes kombëtare të shqiptarëve, si dhe orakulli i pashtershëm i lirisë së tyre”.

“Dekoratën e Flamurit Kombëtar”, Presidenti Meta ja akordoi Sami Frashërit (pas vdekjes) me motivacionin: “Si ideologu i Rilindjes Kombëtare. Atdhetar, dijetar i madh enciklopedist, gjuhëtar, shkrimtar, publicist, përkthyes i shquar, nxitës i vlerave të dijes, shkollimit, emancipimit dhe kurajës qytetare të bashkatdhetarëve.

Si vigani i mendimit filozofik, që u ofroi shqiptarëve programin dhe modelin e shtetit të tyre perëndimor. Në vitet më të vështira të kombit ai ofroi vizionin perëndimor, si dhe strategjinë për Pavarësinë, shtetformimin dhe përparimin afatgjatë të Shqipërisë”.

Përgatiti: Muharem KAMANI

MESAZHI

OBVL vlerëson karrierën e shkëlqyer 31 vjeçare ushtarake të Shefit të ri të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura

Mesazh urimi për gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj

Shefi i ri i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj mori detyrën më 30 korrik 2020, me një ceremoni ushtarake, ku flamurin kombëtar ia dorëzoi ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka. Më herët gjeneralmajor Begaj u betua para presidentit të Republikës Ilir Meta dhe me dorën mbi Kushtetutë.

Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka falënderoi shefin në largim të Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, për të cilin tha se do të vijojë të jetë pjesë e FA për të dhënë kontributin e tij.

Ministria Xhaçka e cilësoi gjeneralmajor Bajram Begajn si një nga ushtarakët më të kualifikuar, mëse i përshtatshëm për sfidat që po kalojnë jo vetëm Forcat e Armatosura, por edhe shoqëria në tërësi.

Në emër të Kryesisë së Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ (OBVL) gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj i kanë uruar marrjen e detyrës së re të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kryetari i OBVL-së kolonel



Shefi i SHP të FA
Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram BEGAJ

Ing.Myfit Guxholli dhe Sekretari i Përgjithshëm i OBVL-së, av.Halil Rama

“Karriera Juaj e shkëlqyer 31 vjeçare ushtarake, e një prej ushtarakëve më të përgatitur e më me vlerë të vendit tonë, duke keni kryer me sukses e devotshmëri ndaj Atdheut një sërë detyrash të rëndësishme, si: Shef i Njësisë Mjekësore Ushtarake dhe Zëvendësre-

jtitor Ushtarak i SUT, Drejtor i Spitalit Ushtarak, Drejtor i Inspektoratit Shëndetësor, Kryeinspektor dhe Këshilltar i Inspektoratit Shëndetësor në Shtabin e Përgjithshëm, Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Forcat e Armatosura etj. është garanci e çuarjes për-

para nga Ju të procesit të modernizimit e profesionalizimit të FA, në kuadrin e NATO-s. Edhe njëherë, ju lutemi gjeneralmajor, prof.asoc.Begaj, pranoni urimet tona të përzemërta”,- thekojnë drejtuesit e OBVL-së në mesazhin e urimit për gjeneralmajor Bajram Begajn.



REFLEKSIONE

Mirënjohja e piktorit Alajdin Tabaku për Dr.Kapisyzin

Halil RAMA

Mirënjohja është shprehja më e bukur e karakterit të njeriut, por kur ajo vjen nga një personalitet i artit e kulturës, si i mirënjohuri Alajdin Tabaku, piktor dhe mësues nga Prizreni, që ka shërbyer për dhjetra vite në Kukës, autor i dhjetra tabllave, peisazheve e portreteve që kanë fituar çmime kombëtar, merr përmasa shumëdimensionale.

Si rrallë herë, “zgjimin” në mëngjesin e hershëm të 5 gushtit 2020 ma bëri një zile nga celulari i tij.

“Alo, Halil. Bashkë me Zylfien jemi shtruar në senatorium...Jemi rëndë që të dy. Jo me COCID, por me ftohje të rëndë...Të lutem na ndihmo me ndonjë mjek që njeh...”.

Një piktor dhe mësues i merituar nga Prizreni, (që ka mbi supë barrën e mbi tetë dekadave jetë e aktivitet krijues të pandërprerë, njëherësh veprimtar i palodhur i OBVL-së) dhe bashkëshortja e tij, Zylfia, ish-kryeinfermiere për dekada të tëra në spitalin e Kukësit kërkojnë ndihmë për shëndetin e tyre. Por, duke konsideruar faktin që spitali universitar “Shefqet Ndroqi”, prej muajsh shërben edhe për të prekurit nga pandemia globale “COVID-19”, ndërhyrja është paksa e vështirë. Gjithsesi nuk ngurova të telefonoja drejtorin, Prof. Asc. Dr. Perlat Kapisyzi. Dhe Ai, edhe në atë situatë tejet të komplikuar bëri të pamundurën për t’i kuruar dy bashkëshortët Tabaku, me përkujdesjen e tij të drejtpërdrejtë. Pas disa ditësh, piktori 85-vjeçar Tabaku më telefonon sërish, për të më



njoftuar se dolën nga spitali, por edhe për t’i shprehur mirënjohjen e thellë prof.Kapisyzit si dhe gjithë stafit të spitalit universitar “Shefqet Ndroqi”. Kjo sipas tij, për faktin se për këtë spital dëgjon fjalë shumë të mira nga banorët kukësiyanë që kanë qenë të shtruar, si për shërbimin higjeno-sanitar shembullor dhe për personelin mjeko-infermier.

“Unë dhe Zylfia, konstatuam nga afër gjatë ditëve që ishim të shtruar në këtë spital aftësitë profesionale të diagnostifikimit si dhe përcaktimin e saktë të terapisë për t’u aplikuar. Po ashtu, si edhe pacientët tjerë të shtruar pamë nga afër unitetin dhe harmoninë mes mjekeve, kjo si rezultat i dashurisë dhe pasionit për punën në shërbim të përmirësimit të shëndetit të pacientëve”,-thekson ndër të tjera.z.Tabaku.

Ai shpreh admirimin e tij dhe të bashkëshortes për stafin e këtij spitali që e drejton me kompetencë e profesionalizëm të lartë prof.dr.Perlati, i biri i gjeneralit Qazim Kapisyzi, i cili shkëlqen nga humanizmi, serioziteti autoriteti i tij në mes personelit mjeko-infermier që e duan dhe e respektojnë. Kështu Ai nderon, veten, Familjen e tij të nderuar me origjinë shkodrane, nga qyteti i lashtë që mban vulën si djepi i kulturës, artit dhe humorit shqiptar.

Ndërkohë, bashkëshortët Zylfie e Alajdin Tabaku shprehin mirënjohje pa kufi edhe për dr. Arben Tanka si mjek i persosur, për shëfën e klinikes prof.dr Silvana, si dhe për infermierën Klava Shyti, e cila me një kujtesë të fortë mbante mend dhe emrat e të sëmurëve.

Po me këtë përkushtim e profesionalizëm shërben



stafi i këtij spitali edhe në pavionin e të sëmurëve me COVID-19. Janë mjekët tanë të talentuar, gjithnjë në roje të jetës së qindra e mijëra pacientëve.

EDITORIAL

Kriza në Mesdhe: “këmbana lufte, apo për paqe të qëndrueshme” ?!

Gjeneral * Piro AHMETAJ

(Vijon nga faqja 1)

Rusia, nga ana e saj ka krijuar një instalim detare në Siri (e vetmja bazë detare jashtë kufijve të ish-Bs) me një projekt ambicioz investimi në infrastrukturen portuale prej rreth 500 milion dollarë dhe akomodimin e deri në 11 luftanijeve, përfshi dhe ato nukleare, nëpërmjet të cilave aktualisht patrullon dhe monitoron Mesdheun Lindor.

Rivaliteti për hegjemoni në rajon, përpjekjet e Rusisë dhe vitet e fundit edhe Kinës për t'u rifaktorizuar fortë dhe për të vënë në provë kohezionin e NATO-s dhe BE-së, e kthen Mesdheun në një rajon me rëndësi strategjike në të cilin, përfshi edhe pretendimet territoriale (border disputes), dhe ato të ndarjes së hapësirave detare (kryesisht për Zonat Ekskluzive Ekonomike) mund të riciklojnë dhe iniciojnë konflikte me efekte deri në nivel global.

II. MARRËVESHJET DHE MOS-MARRËVESHJET QË PO TRONDISIN PAQEN NË MESDHE:

Megjithë përpjekjet, veçanërisht stabiliteti në Mesdheun Lindor mbetet ende i brishtë. Thelbi janë mosmarrëveshjet Greko – Turke, që lidhen me ndarjen e zonave ekonomike detare (EEZ). Të dy shtetet janë anëtare të NATO-s, megjithatë aleanca e 30 vendeve nuk ka ende një mekanizëm për të ndaluar apo zgjidhur mosmarrëveshjet midis vendeve anëtare.

Shqetësimi turk qëndron në faktin se duke patur vijën bregdetare më të gjatë në rajon, nuk mundet të lejojë që një sërë ishujsh Grek përballë këtij bregdeti të kenë të njëjtën peshë në ndarjen e hapësirave detare.

Kjo politikë tashmë mbështetet dhe nga doktrina Turke “The Mavi Vatan” (Blue Homeland), inicuar në 2006, dhe formalizuar në Shkurt 2019 me stërvitjen detare me të njëjtin emër. Sipas kësaj doktrine Turquia zotëron një hapësirë detare të barabartë me gjysmën e sipërfaqes tokësore të Turqisë e shtrirë në detin e Zi, Egje dhe Mesdhe.

Greqia i refuzon pretendimet e Turqisë mbi ishujt e Egjeut, dhe ka kërkuar që t'i zgjidhë nëpërmjet Gjykatës Ndërkombëtare që në vitin 1974. Megjithatë Greqia aktualisht ka ndërmarrë një fushatë diplomatike shumplanëshe për nënshkrimin e marrëveshjeve për delimitimin e hapësirave detare me disa vende, Italinë, Egjiptin, Qipron, Shqipërinë, etj.

7 muajt e fundit, hapësira detare e Mesdheut është acaruar nga 4 marrëveshje bazë-delimitimi:

1. Marrëveshja Turqi – Libi: “Dominim nga Turqia i Mesdheut Lindor; si kërcënim ndaj sovranitetit detar të Greqisë, si dhe anashkalim i ambicieve dhe interesave të Francës, Italisë, etj., në Mesdheun Lindor. Kjo



marrëveshje, e Mirëkuptimit midis Turqisë dhe “Qeverisë së Mirëkuptimit të Libisë” është kundërshtuar nga qeveria e Libisë Lindore.

2. Marrëveshja Greqi – Itali: kjo marrëveshje mund të konsiderohet se arriti dy qëllime, e para ndau përfundimisht zonën ekonomike ekskluzive midis dy vendeve, dhe e dyta, paraqet një “Rivalitet ndaj marrëveshjes Turko - Libiane, si dhe ndaj dominimit absolut të Turqisë në Mesdheun Lindor me rezervë gazi dhe peshë gjeopolitike”.

3. Marrëveshja Izrael - Qipro - Greqi: tre marrëveshjeve të mësipërme i shtohet dhe ajo e projektit SEAMED si “Përpjekje për të rivalizuar dhe balancuar Turqinë = me Projektin SEAMED 6 miliard Eur, i cili furnizon 10 % me gaz në Europë”.

4. Marrëveshja detare Egjipt-Greqi: “si benzinë në zjarrin e mosmarrëveshjeve”!

Ashtu si dhe ajo Turko – Libiane kjo marrëveshje mbivendosin një hapësirë detare, çka e agravoji më tej situatën. Për Turqinë, sigurisht kjo marrëveshje është e pavlefshme, duke theksuar se: “Greqia dhe Egjipti nuk kanë asnjë kufi detar të ndërsjellë dhe se marrëveshja dhe zona e demarkuar në marrëveshje gjendet në shelfin kontinental të Turqisë”.

Situata e krijuar ka sjellë përplasje edhe brenda politikës edhe mes vendeve. Keshtu, ndërsa, kryeministri grek Mitsotakis deklaroi se marrëveshja me Egjiptin është “në përputhje me të drejtën ndërkombëtare”, ish-ministri i jashtëm i Greqisë, Kotzias, e kontestoi, duke shtuar se me këtë hap “Greqia ka dobësuar fuqinë e saj të negociimit në të ardhmen me Shqipërinë dhe Turqinë”. Nga ana tjetër, edhe opozita egjiptiane, e ka cilësuar këtë marrëveshje të pavlefshme, pasi besojnë se Egjipti ka humbur nga zona ekskluzive ekonomike disa qindra miliona dollarë.

Situata mbetet mjaftë e acaruar dhe në rangun e diplomacisë ndërkombëtare. Athina po e “ngre fort zërin” dhe: “nuk përjashton opsionin e një konfrontimi ushtarak edhe nëse do

mbeten vetëm në mbrojtje të sovranitetit detar të Greqisë”. Por kundërpërgjigja vjen menjëherë nga Ministri i Mbrojtjes së Turqisë: “E them me siguri matematike se, Greqia nuk do të dëshironte të niste një luftë me Turqinë, dhe kështu MM të Greqisë do t'i ketë rrëshqitur goja ...”!

Gjithashtu, Ministri i Jashtëm turk, Cavusoglu akuzon Francën se sillet si “gangstere”, duke paralajmëruar, se çdo sulmuesi ndaj një anijeje turke do t'i duhet të “pagojë një çmim të lartë”. Megjithatë, Ankara nuk dëshiron që konflikti të përshkallëzohet, edhe pse për Turqinë, është Greqia duhet të sillet “në mënyrë të arsyeshme”.

Në terren, tonet rriten dhe incidentet janë kërcënuese, pasi një flotë turke e përbërë prej anijeve ushtarake, si dhe anije kërkimore po kryejnë kërkime për gaz në zonën detare mes Qipros dhe ishullit të Rodosit, për të cilën Greqia pretendon se i përket EEZ të saj.

Franca, e konsideruar si një “mik i vërtetë i Greqisë”, përkundër edhe “shqetësimit të USA”, ka përforcuar praninë e anijeve ushtarake, në kuadër të stërvitjeve të përbashkëta në rajon!

Gjithësesi, Presidenti Erdogan, ka deklaruar se mbetet i hapur për dialog duke theksuar se aijet turke nuk kanë cënuar asnjë ligj ndërkombëtar dhe kërkimet do të vazhdojnë deri më 23 gusht.

Ndërsa, prej javësh me rritjen e tensioneve Kancelarja gjermane Angela Merkel ka bërë thirrje udheheqesve të dy vendeve për të shmangur konflikte dhe zhvillojnë dialogun.

Pavarësisht këtyre zhvillimeve, BE dhe SHBA janë shprehur vetëm për vetpërmbytje dhe dialog, por duket se BE, do të jetë violina e pare për ta ndaluar përshkallëzimin e konfliktit mes Greqisë dhe Turqisë, edhe pse për momentin duket se nuk do të vendosë masa ndëshkuese.

Gjithësesi, lufta është opsioni i fundit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, pasi historia na ka mësuar se nga përballjet e armatosura nuk ka fitimtarë, të gjithë dalin të humbur.

Thënë këtë, besoj fortë se meknizmat diplomatike do të privalojnë dhe një strategji afatgjate mes vendeve që ndajnë interesa të përbashkëta, në bashkëpunim dhe nën monitorimin e BE, NATO, SHBA, do të adresojnë burimet e mosmarrëveshjeve dhe duke i transformuar ato në oportunitete, në dobi të paqes, stabilitetit dhe prosperitetit të qytetarëve dhe vendeve të rajonit!

III. Vlerësime strategjike mbi marrëveshjen detare Shqipëri-Greqi:

Ri-theksoj se zhvillimet gjeopolitike dhe pesha e 4 marrëveshjeve të sipërcituara, po ndiqet me shqetësim shtesë në të gjitha vendet e Mesdheut, si dhe SHBA, NATO, Rusia dhe jo vetëm.

Po me negociatat Shqiptaro – Greke çfarë po ndodh? Si mundet të lexohet deklarata e zotit Kotzias, se “Greqia ka dobësuar fuqinë e saj të negociimit në të ardhmen me Shqipërinë” ?!

Lexuar kështu: “heshtja e qeverisë në ikje, lexohet, si kapitullim pa kushte ndaj interesave gjeopolitike të RSH”, pasi institucionet zyrtare kanë përgjegjësi kushtetuese të informojnë shqiptarët për impaktet e këtyre 4 marrëveshjeve ndaj interesave detare të RSH, si dhe mbi gjëndjen dhe rezultatet e grupit negociator, problematikat dhe pritshmëritë e negociatave me Greqinë, përfshi trekëndëshin detar mes Greqisë – RSH - Italisë ?!

E thënë me thjeshtë, përtej përqa-sjes propagandistike në 7 vjet, qeveria në ikje dhe Institucionet përgjegjëse, kanë dështuar për ti dhënë zgjidhje delimitimit të ujrave detare me Greqinë.

Të mos keqkuptohemi, nuk po rekomandoj: “as t'i biem Grekut, as shpallim lufte mesdheut”! Në të kundërt, besoj fort se dialogu konstruktiv, i bazuar në konventat ndërkombëtare dhe paqja e qëndrueshme mbetet jo vetëm opsioni i vetëm por sfidë dhe përgjegjësi e përbashkët.

Kështu, në planin afatshkurtër, në cilësinë e ish-këshilltarit, do t'i rekomandoja Presidentit të Republikës që, mbështetur në nenin 92/h të Kushtetutës, t'i kërkojë Ministrin të Jashtëm (Ai dhe Kryeministër): “informacion shterues mbi vlerësimet e RSH mbi këtë situatë dhe 4 marrëveshjet e sipërcituara, si dhe gjëndjen e ekipit zyrtar, problematikat dhe produktin e negociatave”.

Në planin afatmesëm, mbetem shpresëplotë, se në programin e qeverisë 2021-2025, jo vetëm që kjo çështje do të vendoset si sfidë politike, por do ti jepet zgjidhje përfundimtare delimitimit të ujrave detare me Greqinë, në mënyrë që asetet në këtë hapësirë të përdoren në dobi të mirëqënies të qytetarëve dhe shoqërisë së dy vendeve tona.

*** Gjeneral @ Piro AHMETAJ,**
Këshilltar për Sigurinë
Kombëtare në PD,
Ish-Këshilltar Ushtarak i
President të Republikës

DOKUMENTARI

Video, foto, jetëshkrime plot vuajtje e halle të persekucionit politik mbi nënat, vajzat e gratë shqiptare në komunizëm

Mimoza Dajçi, dokumentar mbi persekucionin politik të grave

Nga Halil Rama

Së shpejti pritet të dalë në qarkullim një dokumentar kushtuar femrave shqiptare që u goditën nga diktatura me e egër komuniste në Europë. Skenariste dhe regjisore e këtij dokumentari është gazetarja dhe aktivistja e të drejtave të njeriut Zj. Mimoza Dajçi, tashmë një emër i njohur për publikun shqiptar.

Duke biseduar me Mozën mësojmë se ky dokumentar ishte një ide e heshtur e saj, por që priste rastin për tu bërë realitet. Në të përfshihen video, foto, jetëshkrime plot vuajtje e halle të persekucionit politik mbi nënat, vajzat e gratë shqiptare në komunizëm. Siç dihet, - thotë ajo, përveç burrave, fshatarit, klerit e intelektualëve të shquar të kombit, ai rregjim nuk kurseu as gratë e fëmijët. Por i torturoi, burgosi, vrau, internoi e i pushkatoi padrejtësisht si dhe burrat.

Rastet janë me mijra. Sa e sa gra e fëmijë të zbathur, pa ngrënë e të mërdhirë në borë e akull, mbyllën sytë e jetën e tyre të pafajshëm mbrapa atyre telave me gjemba që izoloj vendin nga Europa e Perëndimi.

Dokumentari paraqet edhe gra të huaja që vuajtën nëpër burgjet shqiptare, ku pas burgosjes i priste internimi duke pësuar tragjedi që lanë gjurmë të thella në jetën e tyre.

Po ashtu pasqyrohen me realizëm divorcet që ishin hallkat kryesore për shkatërrimin e familjes.



Lufta e klasave ishte prezente kudo, në çdo gjymtyrë të jetës bashkëshortore, nëse djalit apo vajzës do ti arrestohej babai apo nëna, divorci ishte i pashmangshëm, përndryshe kamioni tek dera dhe internimi. Drama nga më të rëndat përjetuan në ato vite dhe akoma nuk po e marrin veten.

Për Mozën ky nuk është rasti i parë që angazhohet si regjisore në SHBA.

Ajo ka drejtuar nga ana skenike edhe Festivalin e 16 të Kishës Katolike "Zoja e Shkodrës" në Harsdalle, Neë York; ka përgatitur koncerte dhe aktivitete me tema të ndryshme patriotike e artistike. Ajo që të bie në sy tek ajo është përkushtimi ndaj të drejtave të grave dhe fëmijëve si në Shqipëri ashtu edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku jeton prej 20 vitesh. Es-

htë një femër inteligjente, e palodhur e pakursyer për çështjen kombëtare. Shpesh na surprizon me arritjet e saj. Si publiciste e gazetare, pak kohë më parë botoi librin e saj "E bukura nën pranga", që unë pata fatin të jem redaktor. Edhe dokumentari që përcjell aspekte të genocidit komunist ndaj femrës shqiptare, do të zërë një vend të sukseshëm në karrierën e saj.


PROFIL

FADIL SALA

ISUF SALA



Nga Fadil Sala



Koha ecën ndër vite, dekada e shekuj, duke lënë në kujtesë gjurmë, e më pas për t'u rizgjuar. Kështu po ndodh edhe me mua, teksa shikoj një foto të babait tim, Isuf Ibrahim Sala. Më vijnë mendime nga fëmijëria ime e largët e më pas në etapa të tjera të jetës dhe deri më sot, ku ai nuk është më në jetë. Po hedh keto shënime në leter dhe më duket sikur po bëj një dokumentar ku personazh kryesor është babai im, i cili na rriti dhe na edukoi me ndershmëri, me djersën e ballit, na mësoi si të kapeni fort pas punës e jetës.

Kush ishte Isuf Sala?

Isuf i ka lindur (1900-1987) në Shërngjergj të

Isuf Sala, mjeshtri duarartë

malësisë së Tiranës, një fshat malor, jo larg nga Tirana.

Terreni malor i fshatit me pak ngastra toke e vështirësonte jetën e malësorëve për të siguruar të mbjellat me dridhëra buke, ku më së shumti zbrisnin nëpër qytete apo fshatra fushore për të blerë drithin, por kishte edhe nga ato malësorë që merrnin rrugën e kurbetit sezonal, për të fituar ca më tepër të holla, e mandej me ato të siguronin drithin për dimrin e egër që kishin përpara. Në kohë të vështira për të mbajtur familjen, edhe Isufi kishte emigruar deri në Greqi. Kishte përvetësuar mjaft mirë zanatin e muratorit dhe ishte bërë mjeshtrë në gdhendjen e gurit. Punonte shumë mirë, i përqëndruar në punë dhe fjalëpak. Kur kemi zbritur nga malësia këtu në Tiranë, ndërkohë që po bënim shtëpinë tonë në Shkozë u rrinte ustallarëve në kokë duke i udhëzuar gjatë punimeve. Thoshte, se do kishte dashur vetë të punonte, por që nuk mundte prej moshës. Te dy me Fatimen rritën dhe edukuan gjashtë fëmijë, Hatijen, Ismailin, Adilen, Kadrijen, Bedriun, Fadilin, nga ku trashëguan vyrtete të cmuara nga prindërit tanë, urtësi dhe ndeshmëri.

Isuf Sala ishte një njeri punëtor dhe fjalëpak, ishte një burrë i urtë, i cili fliste aty ku duhej dhe kur duhej, sic thoshnin miqtë dhe shokët e tij "Ishte nga ata bur-

ra që i hanin duart për punë " Gjatë jetës së tij, koha e sprovoi në sisteme të ndryshme politike, në të cilat jetoi privatizimin dhe kolektivizimin. Aso kohe ishte shprehur: "Prona private është begatia e familjes, kurse kooperativat u bënë burgu jonë, u bene mjerimi i jonë."

Ishte nga ta ustallare që mbanin rradhe, kush e kush ta merrte sa më parë në ndërtimin e shtëpive, por sidomos në ndërtimin e mullinjëve të bluarjes, me të cilët ishte bërë mjeshtrë për punime cilësore. Në ate kohë cdo lagje në Shëngjergj kishte pothuajse mullinjtë e vet të bluarjes. Ka ndërtuar mullinjtë në Shënmëri, në Urë, në Skrep, Shëngjin etj.

Me mendjen e tij të hapur (novatore) Isuf Sala ishte i pari në malësinë e Shëngjergjit i cili shpiku një vegël artizanale, e cila quhej Terstile, e cila shërbente për përpunimin e leshit, nga ku i gjithë fshati mbante rradhën si e vetmja vegël në të gjithë zonën. Më vonë një vegël e tillë u ndërtua edhe në fshatin Shenmëri.

Lufta Antifashiste dhe Nacional Çlirimtare e pozicionoi Isuf Salën dhe familjen e tij krahës shumë bashkëfshatarëve të tjerë, në ndihmë të partizanëve me ushqime dhe veshmbathje.

Shumë herë, me mushkat e ngarkuara me ushqime (Vijon në faqen 11)

NDERIMI

Kushtuar njeriut të vërtetë, krijesit virtuoz dhe unikal, “mikut të të gjithëve”

SHPENDI TOPOLLAJ

PERSONALITET I SHQUAR I KULTURËS SONË BASHKËKOHORE

- Para pak kohësh, në ditët e parë të pranverës 2020, Shpendi Topollaj, shkrimtar, kritik dhe studiues i njohur, në kolanën e 50 librave, pas librit “Esse. Rreth shprehjeve mitologjike”, shtoi më të fundit botim, “Dantja... dhe të tjerë”, ku ka përzgjedhur korifentë e letrave, ndër shekuj: Dante, Petrarka, Bokaçio, Shekspiri, Hygoi, Pushkini, Tolstoi, Esenini, Cvajgu, Eminesku, Shollohov, përfshi edhe shkrimtarët tanë: Fishta, Lazgushi, Kadareja e Dritëro Agolli, etj, etj.



Nga **NIKOLLA SUDAR**

“Njerëzit e mirë, - thotë një fjalë e urtë, - janë zbukurimi i vërtetë i jetës”. Por kur njerëzve të tillë Perëndia u jep edhe talentin, atëherë e ngrenë atë në majat më të larta. Në çdo epokë të shoqërisë njerëzore ata janë vlerësuar dhe kanë fituar edhe përjetësinë.

Sapo lexova kushtimin e shkrimtarit dhe mikut tim të vjetër, z. Kadri Tarelli, kushtuar njërës prej krijesve më të arrirë në letërsinë e sotme shqipe, shkrimtarit të shquar dhe mbi të gjitha “njeriut të mrekullueshëm” z. SHPENDI TOPOLLAJ, si për prodhimtarinë e bollshme, por sidomos për atë tematikë të larmishme dhe tepër cilësore, që sot më tepër se kurrë ka nevojë shoqëria shqiptare. Singjer-

isht jam i ndërgjegjshëm se nuk jam në gjendje të rivalizoj me z. Tarelli, por le t'i bashkangjiten këto fjalë tepër modeste zemre, atij ligjërimi befasues kushtuar këtij personaliteti të shquar të artit dhe kulturës shqiptare.

Vlerësimi dinjitoz i ardhur nga India e largët i bën nder jo vetëm këtij krijuesi të rrallë, por gjithë letërsisë sonë bashkëkohore, duke e lartësuar akoma më tepër emrin e mirë të Shqipërisë nëpër botë.

Duke e mbyllur këtë ligjëratë të shkurtër mund të them me plot kuptimin e fjalës se është fat i madh për cilindo që të ketë një mik të pazakontë, siç është SHPENDI YNË i nderuar. Me këtë rast mjeshtrit të mrekullueshëm të mendjes dhe të shpirtit njerëzor i uroj shëndet, jetë të gjatë dhe gjithnjë arritje të reja dinjitoze si deri më sot.

Isuf Sala, mjeshtri duarartë

(Vijon nga faqja 10)

qime, rrugë pa rrugë duke udhëtuar natën, ka mbërritur në bazat e partizaneve tek Kroji i Kuq apo në Qafë të Martaneshit.

Ndërsa djali i madh, Ismail Sala, doli partizan, duke iu bashkuar Br.3-S, e cila zhvilloi luftime në shumë qarqe të Shqipërisë deri në Sarajevë të ish-Jugosllavisë.

Për meritat e tij si luftëtar me armë në dorë për clirimin e atdheut, ai ka gëzuar statusin e veteranit të luftës. Dihet historikisht, se me kapitullin e Italisë fashiste, shumë ushtarë italianë, robër lufte mbetën në Shqipëri, në pritje të mbarimit të luftës dhe të ri-atdhesimit të tyre. Në Shëngjergj, Komiteti i Luftës shpërndau nga dy-tre robër italianë në shtëpitë e zones. Isufi e dinte gjendjen e dobët ekonomike të disa prej fshatarëve të tij, kështu që u propozoi që të merrte nën kujdesje dhjetë italianë. Në mes tyre ishte

edhe një officer, Epi Pali quhej, vinte i dobët dhe shëndetligë. Kur erdhën pushtuesit nazistë, Isufi i fshehu duke i strehuar në Malin e Fëlqetit, atje ku kishin stanët e bagëtive. Në një rrugëtim të një kolone gjermane, të cilët kontrollonin imtësisht deri edhe kasollët e bagëtive, Isufi për siguri dhe pamundësi të shëndetit të Epi Palit, e fshehu atë duke e mbuluar me rroba të vjetra shajaku dhe dëngje leshi, kurse nëntë të tjerët u fshehën në thellësi të pyllit të gështenjave.

Mbas clirimit, Isuf Sala ka punuar si specialist i murit të gurit cep më cep të Shqipërisë, deri në ndërtimin e hidrocentralit të Shkopetit. Në kohën e kooperativave bujqësore, në tabelën emulacionit, në qendrën e fshatit të Shëngjergj-it ishte shkruar një shkrim stimulues me titullin “Isuf Sala, mjeshtri duarartë”. Ky shkrim është një panoramë e shkurtër e babait tonë e jetës dhe e përkushtimit të tij për punën. Le të mbetet ai për ne fëmijët krenaria jonë dhe për brezat e tjerë të Salajve që do të vijnë, pasqyra e virtyeve më të mira.



VLERËSIM I MERITUAR PËR PERSONALITETIN E LETRAVE SHQIPE, SHPENDI TOPOLLAJ

Tnderuar miq e dashamirë, krijues dhe lexues të letrave shqipe!

Një tjetër lajm i bukur më erdhi nga India: Vlerësim me certifikatë; “Noble Peace Personality Award”, kushtuar Shpendi Topollaj, veprimtar shoqëror, shkrimtar, poet, studiues, kritik letrar, së fundit edhe dramaturg. Autor i gjashtëdhjetë librave, një pjesë të përkthyer në Italisht dhe Rusisht. Shpendi është fitues edhe i çmimit “Pushkin”.

Jam i përkëdhelur nga fati që po publikoj këtë njoftim që më ngroh dhe njëkohësisht më bën krenar, për nxjerrjen në dritë të vlerave të letërsisë dhe arteve tona kombëtare, si një mundësi më shumë, për njohjen nëpër botë të kulturës tonë mbarë shqiptare.

Më duhet të theksoj se vlerësime të tilla kanë marrë edhe krijues të tjerë nga vendi, me të tjerësh përmend: Vullnet Mato, Vilhelme Haxhiraj-Vranari, “Vivra”, nga Vlora, Kujtim Mateli, por edhe nga Durrësi, si Nikolla Spathari, Agim Bajrami dhe Kadri Tarelli. Ky është një nderim edhe për Durrësin dhe qytetarinë durrsake, që ka në gjirin e tij veprimtarë dhe krijues me përmasa të tilla, që na nderojnë.

Një mirënjohje i takon Kryetarit, Dr. Preyatosh Das nga India dhe sekretarin e përgjithshëm Prof. George Onsy, nga Egjipti, që bënë të mundur këtë nderim të merituar e të mirëpritur, për këtë intelektual dhe personalitet të njohur të letrave shqipe.

E çmoj lart, duhet thënë e admiroj këtë punë të bukur dhe të vyer. Ky vlerësim nderon njëkohësisht edhe të gjitha poetet, krijueset e studiueset të racës shqiptare, kudo që ndodhen.

Urime dhe suksese Shpendi Topollaj!

Në pritje edhe për të tjerë vlerësime!

Miqësisht!
Kadri Tarelli
Durrës më: 27. 08. 2020

LIBRI

100 VJETORI I LUFTËS SË VLORËS

Prof.dr. Bernard Zotaj promovon librin “EPOPEJA E FITIMTARËVE”

Me datë 26 gusht 2020 në sallën e bibliotekës së Muzeut Historik Kombëtar, në kuadrin e veprimtarive për 100 vjetorin e Luftës së Vlorës, u bë prezantimi i librit “Epopeja e fitimtareve” të Prof. Dr. Kol. Bernard Zotaj. Ky libër që pasqyron me detaje, fakte e dokumente, fotografi e harta luftën heroike të shqiptarëve të Jugut dhe të Vlorës kundër okupatorëve italianë.

Recensent i librit është Prof. Bardhosh Gaçen, konsulent Xhemil Çela. Ai vjen nën redaktimin e Dr. Asllan Zemanit.

Libri është botim i shtëpisë botuese M&B.

Duke zbatuar masat e mbrojtjes nga Covid 19, pjesëmarrja ishte e kufizuar, por nga të gjithë trevat e Shqipërisë. Diskutuan: Dr. Dorian Koçi, drejtor i Muzeut Historik Kombëtar, Andrea Llukani, Xhemil Cela, Bashkim Qeli, Zabit Cuku, Sakip Cami dhe Gëzim Tushi.

Në fund të diskutimeve, autori Bernard Zotaj falenderoi pjesëmarrësit dhe drejtorinë e MHK, stafin e M&B, si dhe Shoqatën Labëria.

Përgatiti; Sakip CAMI



Bernard Zotaj

Epopeja e fitimtarëve

5 qershor 1920-3 shtator 1920

BOTIMET M&B

**100 VJETORI
I
LUFTËS
KOMBËTARE
TË VLORËS
1920**



PORTRETE ME DREJTUES DHE LUFTËTARË




Osman Haxhiu,
kryetar i një lufte fitimtare



Qazim Koculi,
komandant i forcave kryengritëse




Ahmet Lepenica,
komandant i epopesë së fitimtarëve



Ibrahim Abdullahi,
Rilindasi i Vlorës



Selam Musai,
simboli patriotizmit



Memo Mete Brati,
atdhetar dhe komandant çete

Dekoratat e dhëna nga Presidenti i RSH Z.IILIR META për figurat e spikatura të krahinës së Lumit të Vlorës

Zaçe Xhelos	(Pas vdekjes)	“Dekorata e Artë e Shqiptarëve”
Bajram Qamilit	(Pas vdekjes)	“Dekorata e Artë e Shqiptarëve”
Azem Sulos	(Pas vdekjes)	“Dekorata e Artë e Shqiptarëve”
Ali Metushit	(Pas vdekjes)	“Dekorata e Artë e Shqiptarëve”
Qazim Koculit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
Çauš Tafilit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
Zyber Musait	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
Demir Mystehakut	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
Çauš Mehmetit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
Mehmet Fegës	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
Mane Aliut	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
Selman Hysenit (Gjondeda)	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
Fejzo Tafilit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
Bajram Mehmetit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
Hysni Fallanit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
Hakim Hysenit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
Isuf Rustemit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
Mehmet Musait	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
Fejzo Islamit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”
Sherif Cenajt	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”
Muhamet Bedinit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”
Mato Hasanit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”
Halim Rakipit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”
Gani Iliazit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”
Sulo Hoxhës	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”
Todi Anastasit (Lubonjari)	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”
Toli Kitës	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”
Rubie Hosit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”
Miserdhe Rexhepit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”
Mehmet Selimit	(Pas vdekjes)	“Dekorata e Artë e Shqiptarëve”
Rrapo Çelos	(Pas vdekjes)	“Dekorata e Artë e Shqiptarëve”
Hasan Hysos	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
Hodo Zeqirit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
Rexhep Sulejmanit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
Birbil Sinanit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”
Çoban Nuredinit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”
Selim Sulejmanit	(Pas vdekjes)	Titulli “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”
Z. Mumtas Dhrami Dekorata		“Nderi i Kombit”



STRUKTURA E ORGANIZMIT USHTARAK

